Kronikë

Tempulli/ Shisnin kokainë me doza, 3 të arrestuar, 3 në hetim në Fier (EMRAT)

Në kuadër të megaoperacionit Tempulli, policia e Fierit ka vënë në pranga 3 persona dhe 3 të tjerë janë proceduar penalisht, pasi u kapën duke shitur lëndë narkotike me doza

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
14 Nëntor, 11:36 | **Përditesimi: 14 Nëntor, 11:44**

Share

Në kuadër të megaoperacionit Tempulli, policia e Fierit ka vënë në pranga 3 persona dhe 3 të tjerë janë proceduar penalisht, pasi u kapën duke shitur lëndë narkotike me doza.

Policia ka sekuestruar sasi lëndësh narkotike, fara të bimës narkotike cannabis sativa, peshore elektronike, armë sportive, 7 celularë, si dhe shumë parash të përfituara nga shitja e lëndëve narkotike.

LEXO EDHE:
Ish kreu i Bashkisë së Fierit, Baftjar Zeqaj thirret në SPAK: Nuk kam lajm

Sipas policisë u arrestuan në flagrancë shtetasit Albano Mylka, 30 vjeç dhe Enklejano Stefa, 37 vjeç, të dy banues në Fier, pasi nga kontrollet iu janë gjetur dhe sekuestruar si provë materiale, sasi të lëndëve narkotike kokainë dhe cannabis sativa, që posedoheshin me qëllim shitjen në doza, si dhe fara të bimës narkotike cannabis sativa, 1 armë sportive, 1 peshore elektronike, celularë dhe shuma parash të përfituara nga kjo veprimtari kriminale.

Po ashtu u arrestua Olgert Prifti, 36 vjeç, banues në Divjakë, pasi u kap në flagrancë, në Lushnjë, teksa shiste doza të lëndës narkotike kokainë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Policia po ashtu ka referuar materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin Yzedin Veliu, 21 vjeç, banues në Fier, për shtetasin Iigli Beqiraj, 18 vjeç, banues në Lushnjë dhe për një 17-vjeçar, banues në Lushnjë, pasi në 3 raste, u kapën në flagrancë, gjatë tentativave për të shitur në qytetet ku banonin, doza të lëndës narkotike cannabis sativa, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: kokaine | Megaoperacioni Tempulli | Fier

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Ju duket e drejtë që buxheti i vitit 2024 po diskutohet online?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

'Tempulli' po transportonin drogë me thasë drejt Tiranës, 3 të arrestuar në Lezhë! Sekuestrohen 40 kg kanabis

13 Nëntor, 10:19

Dritan Rexhepi u arratis nga Ekuadori nga një gabim në sistemin e burgjeve, një tjetër firmoste në emër të tij! 'Escobari shqiptar' trafikoi 4 ton kokainë në Itali

13 Nëntor, 08:59

Goditi me stol arbitrin në ndeshjen Apolonia-Vora, në kërkim 35-vjeçari në Fier

12 Nëntor, 13:32

Braçe kërkon ndërhyrje për trajtimin e vrimave në trupin e argjinaturës së lumit 'Shkumbin': Në rast të motit të keq, fshatrat do jenë nën ujë

12 Nëntor, 10:01

VIDEO/ Tensione në Apolonia - Vora, tifozët miq godasin arbitrin e katërt! Blerim Ziri humbet ndjenjat për disa momente

11 Nëntor, 18:39

Më shumë shpenzime për prodhimin, fermerët në Lushnjë shtrenjtojnë vajin e ullirit

Yrjet Saliasi

11 Nëntor, 16:17

Fier, plagos me armë bashkëfshatarin dhe ikën me vrap (VIDEO)

11 Nëntor, 12:56

Fier, zbulohen 3 lokale ku organizoheshin lojëra fati të paligjshme! 4 të arrestuar, 2 nën hetim dhe 1 në kërkim

11 Nëntor, 09:35

Zjarret në qarkun e Fierit dogjën mbi 1 mijë hektarë pyje dhe ullishte, u regjistruan 202 vatra! Zona më e prekur ajo e Pishporos

Kristaq Thano

11 Nëntor, 09:10

Mbahet në Lushnjë festivali folklorik i valleve popullore, artistët me kostume tradicionale parakaluan në sheshin e qytetit

Yrjet Saliasi

10 Nëntor, 17:19

Ministri i Brendshëm nga Fieri: Marrëveshja me Italinë është dëshmi e solidaritetit që ofron Shqipëria

10 Nëntor, 16:08

Pastrohet kanali kullues në fshatin Sheqishtë, shërben për 250 ha tokë bujqësore

10 Nëntor, 15:33

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje